



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 231, datë 27.10.2020

**PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLOREN “PËR
PROCEDURËN E VERIFIKIMIT TË KUSHTEVE DHE KRITEREVE
LIGJORE PËR REKRUTIMIN, EMËRIMIN SI MAGJISTRAT DHE
CAKTIMIN NË POZICION TË KANDIDATËVE PËR PROKURORË, SI DHE
PËR ZHVILLIMIN E KARRIERS SË PROKURORËVE**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 32, 35, 36, 48, dhe 52 nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, gërma “c” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Pika 1 e gërmës “A” të Dispozitave Tranzitore dhe të Fundit të Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, miratuar me Vendimin nr. 171, datë 27.9.2019, ndryshonj si më poshtë;

“Kandidatët që i janë nënshtruar procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit Nr. 84/2016 dhe janë konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, me vendim të formës së prerë, i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, për periudhën pasi vendimi ka marrë formë të prerë“

2. Pikat 2, 3 dhe 4 të gërmës “A” dhe pika 1 e gërmës “Ç” të Dispozitave Tranzitore dhe të Fundit të Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, miratuar me Vendimin nr. 171, datë 27.9.2019, shfuqizohen.
3. Çdo referim në Rregullore, në pikat e shfuqizuara sipas pikës 2 të këtij Vendimi, shfuqizohet.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.



KRYETAR

GENT IBRAHIMI